



Prishtinë: 24.09.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1038_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1815_06_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **24.8.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 24.09.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZHET** ankesa e konsumatorit K.R nga Prishtina me shifër të konsumatorit: DPR – 122197 ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1815_06_18** i datës 13.06.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 24.08.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se njehsori në emër të K. R. ka regjistruar shpenzime të larta. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se njehsori i tij është duke regjistruar shpenzime të larta e dëshmon fakti se kur në prill të vitit 2017 ka shkuar në Shqipëri dhe e ka ndalur energjinë elektrike, kur është kthyer njehsori i tij ka regjistruar energji elektrike. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se ka kontaktuar me një elektrikist i cili ka theksuar se shpenzim i qiraxhiut i ka regjistruar në njehsorin e tij, dhe se e ka sugjeruar që të thërras KEDS-in. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se pas kësaj ka qenë KEDS-i dhe ka kërkuar nga qiraxhiu që të lëshohet energjia elektrike dhe kanë konstatuar se shpenzim në orën e A. R. ka regjistruar në njehsorin e tij, por që punëtorët e KEDS-it vetëm kanë ndërruar njehsorin. Konsumatori ka theksuar njehsori ka qenë në rregull, por telat skanë qenë në rregull.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkalës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se njehsori në emër të K. R. ka regjistruar shpenzime të larta, Bordi i ZRRE thekson se gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës, respektivisht



procesverbalit të inspektimit ka vërejtur se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.62244769 prej TL=62276 kWh dhe TU=53286 kWh e evidentuar në procesverbalin e inspektimit nr.2131616 të datës 14.06.2017 përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike të periudhës 05/2014 dhe 06/2017. Gjithashtu gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.62244769 prej TL=62276 kWh dhe TU=53286 kWh e evidentuar në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0661022 të datës 14.06.2017 përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike të periudhës 05/2014 dhe 06/2017. Gjithashtu Bordi i ZRRE ka analizuar edhe procesverbalin e kalibrimit dhe ka vërejtur se njehsorit elektrik bllobat i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori nuk ka dëmtime dhe se në brendi të njehsorit komisioni nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të konsumatorit se njehsori i tij është duke regjistruar shpenzime të larta e dëshmon fakti se kur në prill të vitit 2017 ka shkuar në Shqipëri dhe e ka ndalur energjinë elektrike, Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit për periudha të njëjta kohore me dy njehsorët elektrik që ka poseduar konsumatori dhe ka vërejtur se konsumatori nuk ka ndryshim të madh të shpenzimeve të energjisë elektrike mes njehsorëve. Shpenzimet mesatare mujore me njehsorin elektrik nr.62244769 për periudhën 06/2014 deri në periudhën 03/2015 është **381 kWh/muaj**, si dhe periudhën 06/2015 deri në periudhën 03/2016 mesatarja mujore e shpenzimit është **449.90 kWh/muaj**, ndërsa dhe me njehsorin e ri elektrik nr.67788371 mesatarja mujore e shpenzimit për periudhën 06/2017 deri në periudhën 03/2018 është **258.70 kWh/muaj**. DMK ka bërë analizimin e shpenzimit të përgjithshëm të energjisë elektrike të konsumatorit, ku mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.62244769 prej periudhës 08/2002 e deri më 06/2017 ka qenë **407.93 kWh/muaj**, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.67788371 prej periudhës 06/2017 e deri më 03/2018 ka qenë **287.44 kWh/muaj**. Pra edhe nga kjo analizë nuk është vërejtur se ka ndonjë ndryshim të madh të shpenzimit të energjisë elektrike mes dy njehsorëve elektrik. Bordi i ZRRE-së gjatë analizimit të shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit konstaton se konsumatori ka dallim në shpenzimin e energjisë elektrike mes dy njehsorëve elektrik sipas kohës së shfrytëzimit të tarifave të energjisë elektrike (kohës tarifore) e që kjo ndikon në rritjen e vlerës financiare të kWh të faturuar, pra shpenzimi i energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik nr.62244769 në tarifën e lartë është **27%** dhe në tarifën e ulët **73%** kurse me njehsorin e ri elektrik nr.67788371 në tarifën e lartë është **72%** dhe në tarifën e ulët **28%**. Bazuar në strukturën tarifore me pakicë të energjisë elektrike të aprovuar nga ZRRE për konsumatorët e rregulluar tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00h deri në ora 22:00h gjatë sezonit të lartë dhe prej orës 08:00h deri në ora 23:00h gjatë sezonit të ulët. Po ashtu njehsori i ri digjital ka të integruar numëruesin tarifor i cili bënë rregullimin e kohës tarifore të shfrytëzimit të energjisë elektrike bazuar në strukturën tarifore me pakicë të energjisë elektrike të aprovuar nga ZRRE.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se sipas elektricitit dhe punëtorëve të KEDS-it shpenzimi i qiraxhiut i ka regjistruar në njehsorin e tij, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizës së bërë procesverbalit të inspektimit të njehsorit nr.2131616 të datës 14.06.2017, dhe procesverbalit të ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0661022 të datës 14.06.2017 nuk është vërejtur se ndonjë njehsor elektrik është lidhur në njehsorin e konsumatorit, siç konsumatori ka theksuar, pasi që po të ishte i kyçur ndonjë njehsor elektrik në njehsorin e konsumatorit atëherë gjatë ndërrimit të njehsorit elektrik do të duhej të vërehej dhe të evidentohet në procesverbale dhe kjo nuk është konstatuar nga KEDS. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes edhe shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit A. R. me shifër DPR – 90043030 dhe se konsumatori ka pasur shpenzim të rregullt të



pikës matëse dhe se pas ndërrimit të njehsorit elektrik, të cilit i është bërë në periudhën 06/2017 konsumatorit nuk i është rritur shpenzimi, e që në kushte normale nëse kishte me qenë i kyçur njehsori i shifrës DPR - 90043030 në njehsorin e K. R. me shifër DPR – 122197, atëherë shpenzimi te shifra DPR – 90043030 do të duhej të rritej, por që në muaj pas ndërrimit shpenzimi madje është zvogëluar. Pra, gjatë analizimit të shpenzimit të energjisë elektrike të shifrës DPR – 90043030 është vërejtur se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.4410886 prej periudhës 08/2006 e deri më 06/2017 ka qenë 222.08 kWh/muaj, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.67788371 prej periudhës 06/2017 e deri më 08/2017 ka qenë 155.00 kWh/muaj.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit K. R.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.